



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19/2024 (JR)
Nr. 19/2 regj.

Tiranë, më 24.12.2024

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrës në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e martë, në datën 21.01.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike, çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 19/2024, datë 29.05.2024, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 730, datë 10.01.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjyqësues
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Ina Rama
Mimoza Tasi
Albana Shtylla
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 të Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Me njoftim individual njoftohet subjekti i rivlerësimit, në të dhënat elektronike të kontaktit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Institucioni i Komisionerëve Publik në të dhënat elektronike të tij dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE